



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**RREGULLORE PËR CAKTIMIN E GJYKATËSVE
TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NGA REGJISTRI I GJYKATËSVE
NDËRKOMBËTARË**

(miratuar më 14 mars 2017)

RREGULLORE PËR CAKTIMIN E GJYKATËSVE TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NGA REGJISTRI I GJYKATËSVE NDËRKOMBËTARË

Rregulla 1

Qëllimi dhe miratimi

- (1) Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve rregullon caktimin e gjykatësve nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë në trupa gjykues në procedura përkatëse para Dhomave të Specializuara, në pajtim me nenin 33 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ('Ligji').
- (2) Rregullorja u miratua prej gjykatësve të Dhomave të Specializuara në seancën plenare të datës 14 mars 2017, bazuar në paragrafin 3 të nenit 25 të Ligjit.

Rregulla 2

Termet e përdorura

Termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimet e përcaktuara në rregullën 2 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara. Njëjësi përfshin edhe shumësin dhe anasjelltas.

Rregulla 3

Caktimi në trupa gjykues

- (1) Gjykatësit e emëruar në Regjistër caktohen në trupa gjykues nga Kryetari, në përputhje me nenin 33 të Ligjit.
- (2) Me fillimin e procedurës së nenit 33 të Ligjit, Kryetari bën caktimin e gjykatësve në trupa gjykues.
- (3) Gjykatësit e mbajnë të informuar Kryetarin për çfarëdo angazhimi, veprimtarie, ose çështje që mund të ndikojë në caktimin e tyre në të ardhmen, në trupin gjykues të një çështjeje gjyqësore.
- (4) Për caktimin e gjykatësve në një trup gjykues, Kryetari nxjerr vendim publik i cili përmban kriteret e caktimit. Ky vendim nuk i nënshtrohet rishikimit gjyqësor.

Rregulla 4

Parimet dhe kriteret e caktimit

- (1) Caktimi i gjykatësve është proces i paanshëm dhe transparent dhe garanton funksionimin efikas, efektiv dhe të shpejtë të Dhomave të Specializuara.
- (2) Gjatë caktimit të gjykatësve, Kryetari niset nga kriteret objektive, si përvoja, kompetenca, përparësia në bazë të datës së emërimit ose të moshës dhe përfaqësimi gjinor e gjeografik, si edhe nga parapëlqimet e gjykatësve dhe disponueshmëria e tyre në kohën e fillimit të procesit gjyqësor përkatës.
- (3) Gjatë caktimit merret parasysh veprimtaria e mëhershme e gjykatësve që me gjasë vë në dyshim paanshmërinë e tyre apo ndikon në ndershmërinë e procesit.

Rregulla 5

Paaftësia e gjykatësve për të kryer detyrat

Kur, për shkak të vetëtërheqjes, përjashtimit ose për arsye të tjera bindëse, një gjykatës nuk është në gjendje të marrë detyrën në kohën e caktimit në një trup gjykues, apo është i paaftë të ushtrojë detyrën në një fazë të mëvonshme të procesit, në vend të tij Kryetari cakton një gjykatës tjetër.

Rregulla 6

Statusi publik i Rregullores

Rregullorja e Caktimit të Gjykatësve është dokument publik.

Rregulla 7

Teksti autentik

Përparësi ka versioni në anglisht i Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

Rregulla 8

Hyrja në fuqi

Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve dhe ndryshimet e saj miratuar në seancë plenare, hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre.